


Mbretëritë angleze dhe franceze në Mesjetë. Lindja e dinastisë osmane

- 
1. *Mbretëria angleze.*
 2. *Mbretëria franceze.*
 3. *Krijimi i dinastisë osmane.*
 4. *Kultura mesjetare.*



1. Mbretëria angleze



William Pushtuesi

Në shek.XIV-XV, u rritën tendencat për krijimin e shteteve kombëtare. Pavarësia në ritje e feudalëve dhe pushteti papal që kërkonte t'i imponohej, do të ishin faktorët që do të ndikonin në rrugën drejt bashkimit. Anglia kaloi një periudhë të gjatë luftrash dhe pushtimesh, por edhe problemesh të brendshme. Sikur të mos mjaftonte fushata e pushtuesve të huaj, në vend mungonte qoftë uniteti i brendshëm territorial, qoftë edhe mirëkuptimi mes feudalëve. Uilliami ishte pushtues norman që mori me forcë titullin e mbretit në Angli. Koha që ai qeverisi, solli paqtimin e vendit dhe grindjet e brendshme u shuan. Pavarësisht kësaj, Uells, Skocia dhe Irlanda bënë një jetë të pavarur.



Eduardi III e përqendroi politikën e tij në dy fronte: bashkimin e vendit dhe heqjen qafe të autoritetit papal.

Të dyja iniciativat e tij patën një përkrahje të madhe. Veçanërisht, lufta për pavarësi nga Papati grumbulloi një numër të madh përkrahësish rreth mbretit. Shkak për këtë u bë edhe zhvendosja e qendrës së Papës, përkohësisht në Avinjon të Francës. Anglezët mendonin se taksat e tyre për Kishën, ndaheshin mes saj dhe armikut të Anglisë, monarkisë franceze. Arritja më e rëndësishme e mbretërve anglezë ishte ndërthurja e pushtetit të tyre me parlamentin, duke krijuar modelin e parlamentarizmit në Europë.

Shoqëria angleze si në të gjithë Europën ishte e mbështetur në jetën e fshatit. Lendlordët (pronarët e tokave) kishin në shërbim të tyre një numër të madh fshatarësh. Fshatarët që punonin tokat e tyre, jepnin detyrime të majme për ata dhe kishën. Në përpjekjet e mbretit për të fituar mbi pushtetin papal, lordët e mbështetën atë. Veçanërisht, kjo mbështetje u pa në jug të vendit. Taksat që jepeshin për Kishën, që e natyrshme që mund të përfitoheshin prej lordëve, çka do të shtonte pasurinë e tyre.

Me zhvillimin e zejtarisë dhe përpunimit e metodave të reja të prodhimit, u shtua kërkesa për lëndë të parë. Me kalimin e kohës duke parë se prodhimet e lehta ishin më të kërkuara, lendlordët i kthyen sytë nga blegtoria. Kjo bëri që shumica e tyre t'i kthenin pronat në kullota për bagëtinë. Për vite me radhë prodhimi dhe përpunimi i leshit u bënë baza e ekonomisë industriale në Angli. Merita e mbretërve në Angli është se ata mbështetën që në fillim zhvillimin e artizanatit dhe të tregtisë. Ata e kuptonin se mbështetja ndaj kësaj shtrese do të sillte zhvillim të vendit. Kjo mbështetje do të shërbente si pikënisje, për lindjen e shtresës së borgjezisë, që do të luante një rol të rëndësishëm në ndryshimet pozitive në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të Anglisë.



Në përpjekje për të fituar autoritetin e tyre mbretërit e Anglisë zhvilluan luftëra të vazhdueshme. Konfliktet kërkonin sigurimin e vlerave të mëdha financiare, që natyrisht binin mbi popullsinë e thjeshtë. Shtimi i taksave rebeloi popullsinë, që nuk ishte e gatshme të varfërohej për hir të fushatave ushtarake. Një situatë në shpërthim e sipër e detyroi mbretin të nënshkruante një nga aktet më të mëdha në historinë e njerëzimit: Kartën e Madhe të Lirive (Magna Karta). Nënshkrimi i saj, i jepte fund arbitraritetit në vendosjen e taksave, në gjykimin e qytetarëve dhe kufizonte fuqinë e mbretit. Nën frymën e këtij dokumenti, Eduardi III, thirri në vitin 1295, parlamentin anglez.

Në këtë parlament ishin të përfaqësuar, lordët laikë dhe fetarë, kalorësit dhe qytetarët. Ky forum mori dalëngadalë frenat e qeverisjes parlamentare në vend. Asnjë ligj nuk mund të dekretohet nga mbreti në rast se ai nuk merret më parë miratimin e parlamentit. Përveç kësaj, çdo vendim që kishte të bënte me financat, ndërtimin e rrugëve dhe mbajtjen e ushtrisë, kalonte përmes parlamentit. Parlamenti anglez, i cili mori trajtë të plotë me krijimin e Dhomës së Lordëve dhe Dhomës së Komuneve, mori përsipër mbrojtjen e lirive të qytetarëve. Në thelb të qeverisjes parlamentare, qëndronte aftësia për të kufizuar pushtetin e mbretit. Për herë të parë në Angli, pushteti i mbretit u zhvesh nga fuqia e pakufizuar dhe hyjnizimi mesjetar. Fuqia qeverisëse ndahej mes parlamentit dhe mbretit. Autoriteti që fitoi parlamenti, bëri që ky i fundit të mos prekej nga asnjë pushtet tjetër. Mbretërit anglezë që guxuan të përjashtojnë parlamentin, nga vendimmarrja në punët e shtetit, u detyruan të largohen nga posti.






2. Mbretëria franceze

Franca doli si shtet me vete pas Traktatit të Verdunit. Procesi i bashkimit të këtij vendi kaloi, përmes një lufte të gjatë mes feudalëve vendas dhe monarkëve anglez. Lordët luftonin mes tyre për të zgjeruar gjithnjë e më shumë territore. Megjithatë, jo rrallë herë ata përdorën lidhjet martesore, të cilat siguronin aleanca të fuqishme politike dhe zgjerim të pronave të tyre. Këtë situatë do ta shfrytëzonin mbretërit anglezë, që i synonin kaq shumë territoret franceze. Kjo mënyrë sjelljeje dhe veprimi i anglezëve, fillimisht u justifikua me faktin se Uilliami (mbreti anglez) ishte nga Normandia. Për këtë arsye ai shihej si mbret i Anglisë dhe i territoreve të Normandisë në Francë. Duke ndjekur shembullin e francezëve, Henriku II (anglez) u martua me dukeshën e Akuitanisë, zotëruese e Francës Jugore. Me këto territore monarkët anglezë, kishin në dorë më shumë hapësira sesa vetë monarkët francezë.

Gjithsesi, kjo situatë do të fillonte të ndryshonte në favor të francezëve. Filipi II, detyroi monarkët anglezë t'i lëshonin Francën veriore. Marrja e këtij territori, fuqizoi mbretin francez në pikëpamje ekonomike dhe politike. Ai u pa si njeriu që rivendosi dinjitetin kombëtar tek francezët. Fitorja mbi anglezët, ishte njëkohësisht një sinjal i qartë edhe për lordët feudalë. Tashmë ata duhet t'i bindeshin pushtetit mbretëror, duke hequr dorë nga fuqia e tyre lokale. Për këtë, Filipi II, do të kujdesej që përmes reformave të arrinte synimet e tij për një pushtet mbretëror të fuqishëm. Reformat administrative ishin hap i parë drejt krijimit të një pushteti të qendëruar. Në thelb të saj u synua që provincat të qeveriseshin nga nëpunës të mbretit të cilët jepnin llogari para tij. Në praktikë kjo do të thoshte se pushteti i lordëve lokalë nuk njihej më.



Luigji IX (1226-1270), ishte mbreti që punoi në dy drejtime: vendosja e kontrollit të plotë mbi territorin francez dhe fuqizimi i pushtetit mbretëror. Luigji IX arriti të përfundonte një paqe me monarkun anglez, sipas të cilës ky i fundit hiqte dorë përfundimisht nga pretendimet mbi Francën veriore dhe veriperëndimore. Ky akt diplomatik i hapi rrugën bashkimit përfundimtar të vendit. Tani pritej që mbreti francez të ishte po aq i suksesshëm në reformat e tij në politikën e brendshme. Modeli i qeverisjes së tij, ishte një dualizëm, mes idesë së një qeverisjeje të drejtë dhe deklaramit të tij se pushteti ishte vullnet i Zotit. Pavarësisht kësaj, Luigji IX, ka meritën që e vendosi pushtetin mbi baza institucionale. Në një formë piramide, nga Këshilli Mbretëror që luante rolin e institucionit më të lartë qëndror, degëzoheshin institucione me funksione gjyqësore, financiare, ligjvënëse dhe fiskale. Ndonëse nuk ishte një parlament i tipit anglez, Këshilli Mbretëror mori iniciativën e hartimit të disa ligjeve që shumë shpejt gjetën zbatim në të gjithë vendin. Ndër të tjera në këto ligje parashihej funksionimi i gjykatës mbretërore. Përcaktimi i kësaj gjykate si më e larta në të gjithë mbretërinë, mënjanonte rolin e gjykatave të lordëve feudalë. Krijimi i këtyre institucioneve u pasua me një reformë monetare, për unifikimin e monedhës në të gjithë territorin e Francës. Shumë shpejt monedha mbretërore fitoi mbi monedhat lokale, duke ndikuar në rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe në zhvillimin e ekonomisë. Forcimi i pushtetit qëndror, i vendosi në plan të dytë ambiciet e feudalëve lokalë dhe krijoi kushtet për zhvillimin e qyteteve, ekonomisë si dhe hodhi bazat për krijimin e një shteti të fuqishëm që do të luaj një rol të dorës së parë në zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në Europë për një periudhë të gjatë.



Përkundër rivales së saj në Europë, Anglisë, Franca përshtati një tjetër model qeverisjeje. Monarkët francezë, jo vetëm që deklaruan se pushteti i tyre ishte një vullnet i Zotit, por me kalimin e kohës e kthyen këtë në një bindje absolute. Parlamenti në Francë (që njihet me emrin Përfaqësitë e Përgjithshme) më shumë u përdor nga mbretërit sa herë që ata ishin në pozitë të vështirë, sesa si një institucion i qëndrueshëm në jetën e vendit. Një rast i tillë ishte në kohën e Filipit IV. Në përpjekje për të fituar mbi feudalët e kishën, në vitin 1302, ai thirri parlamentin me shpresë për të siguruar një përkrahje sa më të gjërë. Ai i dha të drejta këtij institucioni për caktimin e taksave dhe ligjeve. Me këtë veprim kërkoi të japë përshtypjen e një aleance mes pushtetit të mbretit dhe popullsisë. Por menjëherë sa e ndjenin veten të fuqishëm, mbretërit francezë nxirrnin ligje dhe taksa pa marrë paraprakisht pëlqimin e parlamentit. E thënë ndryshe, parlamenti nuk kishte një funksion të përhershëm dhe fuqia e tij nuk respektohej. Më shumë ai ishte në rolin e një këshilluesi sesa në një rol legjislativ. Ai nuk arriti asnjëherë t'i imponohej mbretit dhe të kufizonte pushtetin e tij. Kjo dobësi e këtij institucioni u shfrytëzua për vite me radhë për t'i dhënë mbretit një pushtet të pakufizuar dhe hera-herës arbitrar. Shumë vite më vonë, parlamenti francez do të mund të marrë një rol të vetin. Por kjo gjë nuk erdhi si një mirëkuptim i brendshëm mes palëve siç ndodhi në Angli, por pas ngjarjesh të dhunshme që rrezikuan jo pak stabilitetin e Francës.



Në përpjekjet për krijimin e shteteve kombëtare, monarkët francezë dhe anglezë në mënyrë të pashmangshme u ndeshën me Kishën. Deri në atë kohë Kisha kishte mundur të fitonte një terren gjithnjë e më të madh edhe në aspektin politik.

Feudalët lokalë mbështetnin Kishën, pasi kjo e fundit bekonte pushtetin e tyre. Në luftën për krijimin e shteteve kombëtare, monarkët francezë dhe anglezë nuk kërkonin të ndanin pushtetin e tyre me Kishën. Ndonëse ato nuk u deklaruan haptazi, përkrahën lëvizjet për mos pagim taksash ndaj Kishës. Një mënyrë sjelljeje e tillë duket se shkaktoi reagimin e Papatit. Për vite me radhë taksat dhe mbështetja e feudalëve i kishin dhënë mundësi Papatit të fuqizohej ekonomikisht dhe politikisht. Fundi i shek.XIII, shënoi edhe perëndimin e kohëve të arta për Papatin. Tensioni arriti pikën më të lartë kur Filipi IV, në Francë urdhëroi që e “dhjeta e kishës” të arkëtohej drejtpërdrejtë në arkën mbretërore.

Papa Bonifaci VIII, reagoi menjëherë duke deklaruar se pushteti i Kishës qëndronte mbi mbretin. Filipi IV, jo vetëm që nuk u tërhoq por nxiti arrestimin dhe burgosjen e tij, të cilin e liroi më pas. Me këtë akt mbreti francez kërkonte të tregonte se pushteti i tij nuk mund të vihej në dyshim nga askush. Madje, Filipi IV, ndikoi që për të parën herë selia e Papatit të zhvendosej në Avinjon, duke e vënë tërësisht nën kontrollin e tij. Të njëjtën rrugë ndoqën edhe mbretërit e tjerë. Në shek.XIV, hendeku mes Papatit dhe monarkëve u thellua gjithnjë e më shumë. Mbretërit shpallehin si të tillë pa marrë paraprakisht pëlqimin e Papës. Madje ata nuk munguan të akuzojnë Kishën dhe Papën për ndërhyrje në punët e brendshme shtetërore. Ata kërkuan që Kisha të kufizohej në detyrimet e saj shpirtërore, dhe të hiqte dorë nga tentativa për të ndikuar në pushtetin politik.



Ndërsa mbretërit dhe Papa ishin në konflikt për pushtetin politik, populli i thjeshtë filloi të vërë në dyshim rolin e Kishës. Bujqit paguanin të njëjtat taksa si për zotërinjtë e tyre ashtu edhe për Kishën. Kishte jo pak raste që peshkopë të ndryshëm zotëronin më shumë prona sesa një feudal laik. Përzierja e Kishës me politikën, në sytë e popullit shikohej si një shmangie e fesë nga hallet e përditshme të tyre. Tashmë ata nuk kishin kujt t'i qaheshin pasi edhe feudalët edhe Kisha, për ta kishte të njëjtën pozitë. Zërat e kritikës ndaj Kishës filluan të ngriheshin gjithnjë e më tepër. Personalitete akademike, u ngritën për të kritikuar rolin që kishte marrë Kisha. Profesori i Universitetit të Oksfordit, Uiklefi, dhe kolegu i tij, Jan Husi, në Çeki, goditën praktikën e korruptuara të Kishës në emërim dhe etjen për pasuri. Uinklefi ishte i mendimit se Kisha nuk mund të luante rolin e saj, pasi ajo ishte shkëputur tërësisht nga njerëzit e thjeshtë. Luksi ku ata jetonin i largonte tërësisht nga parimet bazë të krishtërit të shprehura në Bibël.

Në Çeki, kritika e Husit u lidh edhe me çështjen kombëtare. Duke mos përfillur ndjenjat e popullsisë, Papa emëronte peshkopë gjermanë. Natyrisht që këta nuk ishin të mirëpritur nga popullsia vendase. Në vend që Papa të reflektonte ndaj këtyre kritikave, ndërmoi veprime që vunë në rrezik autoritetin e tij. Arrestimi dhe djegia e J.Husit, nxiti një revoltë të ashpër të çekëve që u drejtua jo vetëm kundër Papës por edhe kundër Gjermanisë.

Këto veprime tregonin sesa larg realitetit qëndronte Kisha në raport me popullin e thjeshtë. Interesat e Papatit kishin zëvendësuar rolin e vërtetë që duhej të luante feja në jetën e vendit. Kisha do ta kuptonte vonë batatun ku ishte futur dhe kjo do të vinte vetëm atëherë kur dukej se sa shumë ishin ata që besonin. Kur lindi fryma protestante, atëherë Papati e kuptoi se duhej të reformohej e madje këtë duhej ta bënte sa më shpejt.



Lufta mes mbretërve dhe papëve për dominim, çuan në një dobësim gjithnjë e më të madh të rolit të Kishës në Europë. Për të ndaluar këtë rrjedhë të ngjarjeve, Kisha mendoi të fuqizojë rolin e saj. Kishte ardhur koha që përfaqësuesit e saj të merrnin masa të efektshme, kur panë se dhuna dhe eliminimi i kundërshtarëve, nuk ishte rruga e duhur për rivendosjen e autoritetit të saj. Klerikë të ndryshëm filluan t'i bashkoheshin zërave për ndryshim. Si fillim ata organizuan dhe vunë në funksion këshillat fetarë (koncilet), si forume që kërkonin t'i impononin Papës politika të reja në drejtimin e Kishës. Ndonëse Papati mund të mos ishte dakort të ndante autoritetin e tij me këto organizma, ai ishte i pafuqishëm për të penguar fillimin e reformimit.

Në një seri mbledhjesh në Francë, Gjermani dhe Itali, u morën vendime të rëndësishme. Këto do të shënonin një erë të re në veprimtarinë e Kishës. Ndalimi i martesave të priftërinjve, rikthimi në praktikën e hershme fetare, heqja dorë nga pushteti politik, do të ishin një rrugë e gjatë pa kthim i reformimit të Kishës. Ndonëse Kisha humbi pushtetin politik, të paktën ajo mundi të rifitojë besimin e humbur tek njerëzit. Vulën këtyre reformave do t'ia vërë padyshim Koncili i Trentos. Ndonëse në shek.XVI, uniteti fetar i Kishës u thye, padyshim që roli i katolicizmit në vitet e mëvonshme dhe vetë Papëve do të bëhen promotorë të mbështetjes së zhvillimit dhe ngritjes së vlerave morale të shoqërisë njerëzore.





3. Krijimi i dinastisë osmane

Selxhukët e fuqishëm u shpërbënë në fund të shek.XIII. Nga kjo shpërbërje u krijuan shtete të ndryshme, që u quajtën emirate. Ndër disa të tilla që u krijuan u shqua Emirati që udhëhiqej nga Osmani. Si të gjithë shtetet në Mesjetë, Osmani filloi dalëngadalë të zgjerojë territorin e tij. Nën shembullin e ushtrisë së suksesshme selxhuke për një kohë relativisht të shkurtër, territori i një shteti të vogël arriti të përhapej në tre kontinente: Afrikë, Azi dhe Europë (Gadishulli i Ballkanit). Kjo e shndërroi emiratin e vogël në një perandori, që në histori ka marrë emrin, Perandoria Osmane. Mund të duket paksa paradoksale, por zgjerimi i shtetit osman në kufij kaq të gjerë u kushtëzua nga organizimi politik, material dhe fuqia ushtarake. Nuk duhet të harrojmë se shteti i qendëruar osman ishte në kontrast me shtetet e copëtuara në territoret që ata pushtuan. Copëtimi feudal ishte një ndihmë për suksesin ushtarak të osmanëve. Përpos të gjitha këtyre arsyetimeve nuk mund të harrojmë se fryma e shenjtë që iu dha kësaj lufte dhe përhapja e islamizmit ishin një armë më shumë për fitoren e osmanëve.



Në fillimet e saj Perandoria Osmane u nda në dy njësi të mëdha territoriale-administrative: Turqia Europiane (që osmanët e quajtën Rumelia) dhe pjesa Aziatike, Anadolli. Kjo perandori filloi jetën e saj në shek.XIV, për t'u shpërbërë në vitin 1918, pas Luftës së Parë Botërore. Për shumë shekuj Perandoria Osmane ka pasur një ndikim të madh në ndryshimet që kanë ndodhur në qytetërimin botëror.

Në pikëpamje hierarkike, sulltani ishte në krye të shtetit. Ai gëzonte një pushtet të pakufizuar. Në mabicien e tyre për të krijuar një perandori të madhe dhe të fuqishme, osmanët krijuan një pushtet të qendërzuar në maksimum. Ky lloj organizimi ishte i nevojshëm për të qeverisur në një territor me popuj të ndryshëm. Fryma fetare, u ndërthur edhe në mënyrën e qeverisjes së vendit. Ligji i Sheriatit shërbeu për shumë kohë si ligji bazë i shtetit. Megjithatë, në situata të caktuara, Sulltani dekretonte ligje që ishin të detyrueshme për zbatim. Megjithëse osmanët pushtuan territore të gjëra, në shumë raste ata respektuan vetëorganizimin e popujve të tjerë. Në disa vende dhe për kategori të caktuara popujsh, osmanët njohën të drejtën e vetëqeverisjes nën kontrollin e tyre.



Për shumë kohë principata e Vllahisë dhe Moldavisë ishin autonome. Në territore të tjera kishte krahina autonome (të vetëqeverisura). Në këtë mënyrë, turqit osmanë, mundësuan të ulin tensionet mes tyre dhe vendeve që pushtuan. Ndonëse Sulltani kishte një pushtet absolut, pranë tij vepronin organizma këshillimore. Divani apo këshilli perandorak, ndihmonte monarkun osman në marrjen e vendimeve. Më pas ky këshill u kthye në kabinet ministror. Organizimi fetar ishte i ndarë nga pushteti politik. Në krye të fesë qëndronte Kryetari, që muslimanët e quanin Shejh-ul-islam. Ai ndihmohej në detyrën e tij nga dijetarët e fesë për interpretimin e Kur'anit dhe zbatimin e tij. Kryetari i fesë nuk para përzihej me punët e shtetit. Megjithatë, Sulltani herë pas here i pajiste me prona që quheshin vakëfe. Në përgjithësi, kjo që në pamje të parë duket si ndarje pushtetesh, në fakt i shërbente Sulltanit për t'u vënë në dijeni për çfarë po ndodhte. Ajo ishte shumë larg ndaj formave moderne që mori ndarja e pushteteve në monarkitë europiano-perëndimore.

Për shumë vite me rradhë deri në perëndimin e Perandorisë Osmane, ai ngeli një shtet tipik feudal-ushtarak. Këtë organizim dhe prapambetje, e reflektoi edhe në vendet që pushtoi. Kur Perandoria Osmane mendoi të reformohej ishte shumë vonë. Tanimë shumë prej funksionarëve të saj u bënë pengesë, ndërsa të tjerë që nuk e kuptonin u frikësuan. Pavarësisht të gjitha këtyre, osmanët për shekuj me rradhë i shkaktuan një kokëçarje të madhe Europës, derisa kjo e fundit arriti ta kontrollojë politikisht dhe ekonomikisht.



Forca e selxhukëve dhe pasardhësve të tyre u mbështet tek ushtria. Ushtria osmane u bë shembull i ushtrisë së organizuar më së miri në pikëpamje disiplinore dhe të formimit ushtarak. Ushtria osmane kishte si komandant të përgjithshëm Sulltanin. Ky i fundit në shumë beteja të rëndësishme merrte pjesë personalisht. Në këtë rast **Sulltani mund** të fitonte famë të madhe si në rastin e Mehmetit II që pushtoi Kostandinopojën, por dhe mund të vritej, si në rastin e sulltan Muratit që u vra në betejën e Fushë-Kosovës në vitin 1389. Kjo ushtri e madhe në numër, furnizohej nga popullsia vendase por dhe nga provincat e pushtuara. Bërthama e ushtrisë ishin: jeniçerët, këmbësoria, flota dhe kavaleria, që ishte në shërbim të përhershëm. Përgjithësisht jeniçerët ishte reparti më i specializuar i ushtrisë osmane. Këta rekrutoheshin që në moshë të vogël dhe aftësoheshin në fushën ushtarake dhe të administrimit të tokave osmane. Si trupa të përgatitura mirë, një pjesë e jeniçerëve shërbente në gardën e sulltanit, ndërsa pjesa tjetër kishte mundësinë e një karriere të gjatë ushtarake në varësi të aftësisë së tyre të treguara në fushën e betejës. Pjesa tjetër e nevojave ushtarake, mbushej nga pjesëmarrja e trupave të provincave të pushtuara. Sipas rregullit osman, tokat ishin pronë shtetërore në pronësi të Sulltanit. Ky i fundit ua ndante feudalëve si shpërblim në këmbim të shërbimit ushtarak që ata i jepnin me njerëz, pajisje ushtarake dhe ushqime. Këta të fundit ishin të detyruar t'i përgjigjeshin çdo thirrjeje të sulltanit për pjesëmarrje në luftë, në të kundërt humbisnin të drejtën mbi tokën që iu ishte dhënë. Në një farë mënyre këta ishin vasalë të sulltanit, pa të drejtë pronësie apo trashëgimie të saj. Gjithsesi, një perandori e madhe, me përbërje të shumëllojshme të popullsisë nuk mund të mbahej në këmbë vetëm në sajë të forcës ushtarake. Kohë pas kohe ajo u përball me rebelimin dhe zemërimin e popullsisë të pushtuara, ashtu edhe sikundër shtetet e Europës perëndimore, ia zvogëluan gjithnjë e më shumë hapësirat. Dobësimi dhe shkatërrimi i saj do të ishte i pashmangshëm, por ai erdhi tepër vonë.





4. Kultura mesjetare

Një nga arritjet më të mëdha në kulturën mesjetare, konsiderohet vëmendja që iu kushtua edukimit. Pa një studim të shkencave të ndryshme, bota nuk mund të përparonte apo të zgjidhte enigmat që haste gjatë rrugës së zhvillimit të saj. Meritën për fillimin e mësimdhënies e kanë luajtur institucionet fetare, kishat dhe manastiret. Murgj dhe prelatë të ndryshëm të pajisur me dije fetare dhe laike, ngritën shkolla për mësimin e disiplinave më të rëndësishme si: gjuhë, aritmetikë, astronomi madje edhe mësim për pikturën dhe muzikën. Nga mësimet fillestare u kalua në mësimet e mesme, ku njohuritë zgjeroheshin gjithnjë e më tepër dhe i kushtohej një vëmendje e veçantë disiplinës, moralit dhe respektit. Urdhërit të Jezuitëve, i njihet një meritë e madhe në këtë drejtim.




Faza më e lartë e arsimimit ka qenë Universiteti. Në këtë fazë shkollimi çdo njeri kishte mundësi të fokusohet në një drejtim të studimit të tij si në shkencë mjekësore, juridike, teologjike etj. Është e rëndësishme të theksojmë se fillimisht shkollimi kishte njohuri qoftë laike ashtu edhe fetare. Qyteti i Bolonjës në shek.XI, u bë pikënisja e jetës universitare, me studimet në fushën juridike. Në një kohë relativisht të shkurtër, në qytete të tjera u ngritën universitete ku studiohej në disa fusha, si në Pragë, Paris, universiteti i famshëm i Oksfordit dhe Kembrixhit, Krakovit në Poloni, Napolit dhe Padovas në Itali etj. Me kalimin e kohës, universitetet filluan të udhëhiqen sipas një organizimi të brendshëm. Për këtë ata hartuan statutet e tyre, të cilat u bënë rregulloret e para për funksionimin e çdo universiteti. Jeta akademike në universitete nuk u kufizua vetëm në dhënie të leksioneve, por edhe në organizimin e debateve publike dhe diskutimeve për çështje të ndryshme. Kjo e bëri universitetin gjithnjë e më të hapur për publikun dhe njëkohësisht i jepte jetë pjesëmarrjes së studentëve dhe qytetarëve në jetën universitare.



Për disa shekuj, shkencëtarët në Europë, u përpoqën të çonin më tej të dhënat e dijetarëve të lashtësisë, apo shpjegimet teologjike për fenomene të ndryshme. Për vite dhe shekuj me rradhë, Kisha nuk lejoi të prekej teoria e saj mbi Tokën. Pati shumë dijetarë që nuk i besuan kësaj teorie dhe ngritën dyshimet e veta. Madje ata filluan studimet për këtë qëllim. Që në fillim të shek.XIII, anglezi Bekon hodhi idenë se përmes eksperimentit duhet të vërtetoheshin disa dukuri të natyrës, përndryshe gjithçka do të mbetej teori. Shumë shpejt dijetarët bënë përpjekje të mëdha që përmes eksperimentit të kalohej tek vërtetësia e ngjarjeve dhe dukurive. Por këtu ata u ndeshën me kundërshtimin e Kishës. Galileo Galilei, Koperniku, Brunoja e me rradhë, vërtetuan se toka rrotullohej, se yjësia kishte rregullat e veta etj. Guximi i tyre u kushtoi jetën, por koha u dha të drejtë atyre.

Dijet shkencore pak nga pak u rrënjosën në mendjen e njerëzve. Koha e sundimit të fesë në të gjithë jetën e shoqërisë kishte marrë fund. Lind një epokë e re e humanizmit. Në qendër të tij ishte njeriu që mund të shpjegonte dhe ndryshonte fatet e shoqërisë ku bënte pjesë. Madje botimi i veprave për popullsinë e gjërë u mundësua edhe nga shpikja e shtypshkronjës së parë nga Gutenbergu. Për një kohë të shkurtër librat që kopjoheshin me dorë, tashmë shtypeshin me makinë. Kjo rriste numrin e kopjeve të dala por dhe cilësinë e tyre.



Për shumë kohë, Kisha imponoi gjuhën latine si gjuhë për të gjithë popullsitë. Kjo la në harresë gjuhën e kombeve të ndryshëm. Edhe librat që botoheshin në Europë i nënshtroheshin këtij rregulli. Këtë tabu e theu Dante Aligeri kur botoi në gjuhën italiane veprën e tij. Nga shumë studiues ai ai konsiderohet si themelues i gjuhës italiane. Gjatë shek.XI-XV, përdorimi i gjuhës amtare do të ishte fusha ku u derdhën të gjitha energjitë njerëzore. Vetëm në këtë mënyrë veprat e ndryshme letrare dhe shkencore do të bëheshin më të dashura për publikun. Kjo do të ndikonte drejtpërdrejtë edhe në arsimim. Studimi në gjuhën amtare do të ishte shumë më i lehtë për çdo njeri. Kjo i hapi rrugë pasurimit të gjuhëve të ndryshme dhe studimeve me shumë vlerë në fushën linguistike.

Pas gjuhës një vend të rëndësishëm kishte edhe letërsia. Fillimet e saj i gjejmë në forma gojore që i përngjanin veprave të Homerit si: “Këngët e Rolandit” në Francë, eposi i kreshnikëve në Shqipëri, “Muji e Halili”, “Nibelungët” në Gjermani. Letërsia e shkruar pas Aligerit vazhdoi me Petrarkën, Bokaçion etj.

Në fushën e pikturës, ishin italianët ata që krijuan vepra të papërsëritshme. Duke u mbështetur në artin antik, ata arritën një përsosmëri të lartë duke u bërë frymëzues për artin figurativ në të gjithë Europën. Kontribut të çmuar në këtë drejtim dhanë Donatelo, Mazaço e Xhoto. Ky ishte vetëm fillimi dhe më pas bota do të njohë arritje edhe më të mëdha. Si në çdo kohë, arti reflektoi shkëlqimin e arritjeve të kohës së vet, por duke futur gjithnjë e më shumë elemente të jetës së përditshme të njeriut. Në jo pak raste, me mënyrën e vet, ai kritikoi edhe problemet që kalonte shoqëria.

